VENDIM
Nr.208, datë 24.3.2010

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS, PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN GRAÇANICË, KOSOVË

(Ndryshuar me VKM nr. 992, datë 15.12.2010; nr. 810, datë 23.11.2011)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qeverisë së Kosovës t'i jepet një ndihmë financiare, në shumën 400 000 (katërqind mijë) euro, për t'u përdorur për realizimin e disa projekteve në komunën Graçanicë, Kosovë.

2. Kundërvlefta në lekë për 200 000 (dyqind mijë) euro t'i shtohet buxhetit të miratuar për vitin 2010, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për t'u përdorur në formën e transfertës.

2/1. Fondet e pashpenzuara prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2010, të përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rimbursimin e TVSH-së për kontratat e financuara nga IPA-ja, 2008.

3. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit që në bashkëpunim me komunën Graçanicë, të përcaktojë projektet që do të financohen me ndihmën financiare të sipërpërmendur. FSHZH-ja ngarkohet, gjithashtu, me ndjekjen e realizimit të këtyre projekteve, në përputhje me një marrëveshje që do të lidhet ndërmjet palës përfituese dhe asaj zbatuese.

4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2010.

5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha